



**REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA**  
**GJYKATA E APELIT PRISHTINË**

---

Numr i lëndës: 2020:148733

Datë: 31.07.2024

Numri i dokumentit: 06004223

CAP.nr.1310/23

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, me gjyqtarin individual Adnan Konushevc, në çështjen përmbartimore të kreditorit L.A, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson S.K, avokat nga P....., kundër debitorit Shërbimi Spitalor, Klinik dhe Universitar i Kosovës, Qendra Klinike Universitare e Kosovës, me seli në P....., me bazë juridike përmbartimore-pagesë e pagave jubilarë, duke vendosur lidhur me ankesën e të autorizuarit të kreditorit, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.2567/2020 të datës 27.12.2022, jashtë seance me datë 30.07.2024 mori këtë:

**A K T V E N D I M**

Refuzohet si e pathemeltë ankesa e të autorizuarit të kreditorit L.A, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.2567/2020 i datës 27.12.2022, vërtetohet.

**A r s y e t i m**

Gjykata Themelore në Prishtinë, me aktvendimin e atakuar PPP.nr.2567/2020 të datës 27.12.2022, në pikën një të dispozitivit ka aprovuar si të bazuar prapësimin e debitorit SHSKUK-QKUK në Prishtinë, dhe urdhrin përmbartimor P.nr.2070/20 të datës 03.06.2020, e ka anuluar ndërsa ka refuzuar si të pabazuar propozimin për përmbartim të parashtruar nga kreditori L.A. Në pikën dy, ka caktuar që secila palë bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë i autorizuari i kreditorit, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dytë, ta aprovoj ankesën e kreditorit dhe të prish aktvendimin PPP.nr.2567/2020 të datës 27.12.2022, duke lënë në fuqi urdhrin për përmbartim P.nr.2070/20 të datës 03.06.2020, si dhe të obligoj debitorin në pagesën e shpenzimeve të procedurale.

Gjyqtari individual i Gjykatës së Apelit, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa është e pathemeltë

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditori përmes të autorizuarit të tij, ka paraqitur propozim për përmbartim ndaj debitorit, në bazë të dokumentit përmbartues – Vendimit të Inspektoratit të Punës në Prishtinë 01 Nr.21-1715/94 të datës 10.02.2020, i cili është i plotfuqishëm dhe i ekzekutueshëm nga data 19.05.2020, lidhur me pagesën e një page jubilarë në shumën e prej 550.64 euro, duke kërkuar edhe shpenzimet procedurale.

Përmbartuesi privat, duke vepruar në bazë të propozimit për përmbartim të kreditorit me urdhrin P.nr.2070/2020 i datës 03.06.2020, ka lejuar përmbartimin. Kundër urdhrin për përmbartim pala debitorë brenda afatit ligjor me datën 10.06.2020, ka paraqitur prapësim, ndërsa përgjigje në prapësim ka paraqitur i autorizuari i kreditorit me datën 17.09.2020. Gjykata e shkallës së parë pas vlerësimit të prapësimit dhe përgjigjes në prapësim, me aktvendimin e atakuar ka vendosur decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendimin e saj të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata e Apelit e Kosovës, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika b), g), j) dhe m) të LPK, dhe se drejtë janë zbatuar dispozitat ligjore, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Në rastin konkret pala debitorë me prapësim i është referuar papërshtatshmërisë së dokumentit përmbartimor, prandaj gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka vendosur si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar, për faktin se nga provat në shkresat e lëndës ka gjetur se dokumenti përmbartimor nuk i plotëson kushtet ligjore për përmbartim, konform dispozitave ligjore në fuqi, andaj sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit në rastin konkret dokumenti përmbartimor është i papërshtatshëm për përmbartim edhe nga fakti se me nenin 27 të LPP, në mënyrë shprehimore

është paraparë se “dokumenti përbarimor është i përshtatshëm për përbarim në qoftëse në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”. Në bazë të nenit të sipërcituar del se kushtet në fjalë duhet të plotësohen në mënyrë kumulative dhe se mungesa e vetëm njërit prej këtyre kushteve, e bënë dokumentin përkatës përbarimor të papërshtatshëm për përbarim. Me shikim në shkresat e lëndës konstatohet se dokumenti përbarimor-Vendimi administrativ i Inspektoratit të Punës, 01 Nr.21-1715/94, të datës 10.02.2020, i njëjti në dispozitiv nuk e përmban shumën e detyrimit, e që nuk dihet se si do të ekzekutohet një vendim i tillë. Në këtë drejtim Gjykata e Apelit gjen se qëndrojnë pretendimet në lidhje me papërshtatshmërinë e përbarueshmërisë së dokumentit përbarimor në formën dhe përmbajtjen e tij aktuale, andaj për Gjykatën e Apelit, gjykata e shkallës së parë ka vendosur drejtë kur e ka aprovuar si të bazuar prapësimin e debitorës.

Gjykata ankimore me rastin e vendosjes pati parasysh pretendimet e palës kreditore se me rastin e ankesës është parashtruar edhe korrigjimi i vendimit dhe arsyeja e mosparaqitjes me propozim është se i njëjti është nxjerrë më pas, mirëpo të njëjtat janë të paqëndrueshme dhe të pabazuara, për shkak se me shikim në shkresat e lëndës vërtetohet se me rastin e parashtrimit dhe lejimit të propozimit për përbarim i njëjti është lejuar në bazë të vendimit 01 Nr.21- 1715/94, të datës 10.02.2020, i cili nuk i ka plotësuar kushtet ligjore për tu konsideruar dokument i rregullt përbarimor, dhe fakti se tani është bërë korrigjimi i këtij vendimi kjo nuk ndikon në ndryshimin e vendimit. Duke i vlerësuar të gjitha pretendimet, gjykata ka vlerësuar se pala kreditore as gjatë procedurës e as me ankesë nuk ka propozuar plotësimin e propozimit përbarimor, por vetëm ka bashkangjitur korrigjimin e vendimit, andaj dhe gjykata e shkallës së parë ka qenë e detyruar që të veprojë konform dispozitave ligjore. Eventualisht pala kreditore mund të parashtrtojë propozim të ri në bazë të vendimit i cili i plotëson kushtet për tu konsideruar dokument i rregullt përbarimor.

Ndër të tjera kjo gjykatë, si gjykatë e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në çështjen konkrete juridike në mënyrë të plotë dhe të drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike, e cila nuk vihet në dyshim me pretendimet ankimore. Prandaj për shkak të zbatimit të rregullt të procedurës dhe vërtetimit të tërësishëm dhe të rregullt të gjendjes faktike, drejtë janë zbatuar edhe dispozitat ligjore, dhe gjykata e shkallës së parë për vlerësimin e vet ka dhënë arsye të mjaftuara dhe bindëse faktike dhe juridike mbi faktet relevante për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilën në tërësi e aprovon edhe gjykata e shkallës së dytë.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Kompetenca e Gjykatës së Apelit për të vendosur nga ana e gjyqtari individual në shkallë të dytë bazohet në dispozitën e nenit 3 par. 2 të LPP, me të cilën është paraparë se *”në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual”*.

Nga arsyet e paraqitura me lartë, e në pajtim me nenin 209 par 1, pika b) të LPK-së, lidhur me nenin 17 të LPP-së, u vendos si në dispozitivin të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË  
CAP.nr.1310/23, me datë 30.07.2024

Gjyqtari  
Adnan Konushevc